

Zhvillohet me sukses Konferenca e 3-të Ndërkombëtare Studentore "Inovacioni i udhëhequr nga studentët: Fuqizimi i gjeneratës së ardhshme"

Në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", u mbajt me sukses Konferenca e 3-të Ndërkombëtare Studentore "Inovacioni i udhëhequr nga studentët: Fuqizimi i gjeneratës së ardhshme".

Kjo konferencë solli si risi këtë vit Simpoziumin e Karrierës dhe Aftësive, duke u dhënë mundësinë studentëve për zhvillimin dhe orientimin e karrierës, si dhe të krijojë kontakte të drejtpërdrejta me punëdhënësit potencialë e të nxisë punësimin e tyre me informacion nga ekspertë të fushës.

Në fjalën e tyre përshëndetëse dy zëvendësrektorët e Universitetit të Elbasanit, Prof. Peçi Naqellari dhe Prof. Elvira Fetahu, shprehën vlerësim për pjesëmarrjen e gjerë të studentëve, si nga vendi por edhe nga bota, për angazhimin dhe cilësinë e punimeve të tyre kërkimore shkencore në të gjitha fushat që mbulon Universiteti i Elbasanit. Gjithashtu shprehën një falënderim të veçantë për personelin akademik dhe administrativ për mbështetjen e pakushtëzuar në çdo aktivitet që ka në qendër studentin.

Në përfundim të aktivitetit për studentët u shpërndanë certifikatat e pjesëmarrjes, si edhe çmime të ndryshme. Punimet e tyre do të botohen në Librin e Abstrakteve të Konferencës dhe në Buletinin Special të Universitetit të Elbasanit.







